

Mbt. Vështrim

Reflektim për kulturën në komunikacion

T: Përmirësimi i kushteve për lëvizjen e këmbësorëve, çiklistëve dhe pjesëmarrësve tjerë (të anashkaluar) në trafik.

Ecja në këmbë në etapa të ndryshme të zhvillimit njerëzor ka patur gjithmonë vështirësitë e veta. Edhe pse ecja është forma më e vjetër dhe më universale e udhëtimit, ajo edhe sot në vende të ndryshme ka vështirësitë e veta për lëvizje të sigurtë. Në Kosovë, veçmas pas luftës, hasim në probleme dhe vështirësi të shumta të cilat shprehen me shqetësimet e qytetarëve në lidhje me sigurinë e këmbësorëve në rrugë, sidomos në kryqëzime, dhe përgjithësisht me nivelin jo të kënaqshëm të infrastrukturës rrugore. Krijimi i një sistemi të sigurtë dhe efikas për këmbësorët, me qëllim që lëvizja e tyre të jetë formë praktike dhe e lehtë e udhëtimit, padyshim se do të shpëtonte jetë dhe përgjithësisht do të ndikonte në balancimin e transportit urban në qytet.

1. Këmbësorët dhe çiklistët pjesëmarrës të pambrojtur në rrugë

Sipas të dhënave të Komisionit Evropian sa i përket mobilitetit dhe transportit vërtetohet fakti se ecja ose ngasja e biçikletës (çiklizmi) janë mënyra mjaftë të përdorshme dhe të shëndosha të lëvizjes. Nga të gjitha udhëtimet, 20-40% e pjesëmarrësve në trafik udhëtojnë në këmbë ose me biçikleta. Kjo përqindje, më e lartë është në Holandë dhe më e ulët në Finlandë. Udhëtime në këmbë janë më të shpeshta në Britaninë e Madhe, ndërsa ato me biçikleta në Holandë, Danimarkë dhe Suedi. Ecja është e rëndësishme për të gjithë, por veçanërisht për fëmijët nën moshën 12 dhe të rriturit mbi moshën 65 vjeçare. Biçikleta përdoret më shpesh nga të rinjtë (12-17 vjeç). Në bashkëveprim me shpejtësinë e madhe të pjesëmarrësve tjerë në trafik, këmbësorët dhe çiklistët ngelin si pjesëmarrësit më të pambrojtur në raport me të tjerët. Ata vuajnë pasojat më të rënda nga goditjet e mundshme të pjesëmarrësve të tjerë, sepse në të shumtën e rasteve nuk mund ta mbrojnë veten.

Në Kosovë, sipas raporteve zyrtare të Policisë për vitin 2014 nga aksidentet e shkaktuara në rrugë, kanë humbur jetën 127 persona, ku prej tyre 39 viktima ishin në cilësi të këmbësorëve (30.70%), dhe 6 viktima ishin në cilësi të çiklistëve (4.72%). Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se këto komunitete fatkeqësisht edhe në vendin tonë llogariten si kategori të pambrojtura në rrugë.

2. Rregullat e veçanta për këmbësorët dhe çiklistët

Këmbësorët dhe çiklistët janë kategori ligjore që i nënshtrohen rregullave të trafikut të përcaktuara në Konventën e Vjenës të vitit 1968, por edhe në Ligjin në fuqi për komunikacionin rrugor në Kosovë. Me qëllim të rritjes së sigurisë në rrugë, në disa vende janë përcaktuar masa dhe rregullore shtesë lidhur me lëvizjen e këmbësorëve dhe çiklistëve. Këto kanë të bëjnë me pajisjet e detyrueshme për të siguruar dukshmëri më të madhe të pranisë në rrugë për çiklistët, ndërkaq për fëmijët - programe dhe aktivitete mësimore dhe jashtë mësimore lidhur me sjelljen, edukatën dhe kulturën e tyre në trafik, etj. Meqenëse jemi këtu nuk mund të lë pa përmendur fushatat vetëdijësuese dhe aktivitetet e shumta për sigurinë në rrugë, sidomos ato me nxënës në shkollat e Republikës, të cilat tash e tri vite janë duke u zhvilluar nga Forumi i Kosovës për Siguri në Rrugë, AMRKS, dhe Kolegji Tempulli. Të gjitha këto aktivitete janë përkrahur fuqishëm nga Policia e Kosovës, MASHT dhe këtë vit edhe nga Komuna e Prishtinës.

3. Përmirësimi i kushteve për lëvizjen e këmbësorëve

Mendoj se është koha e fundit kur institucionet tona qeveritare (komunale dhe qendrore) të marrin masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës për lëvizjen e këmbësorëve. Këto veprime, kur është fjala për udhëtime të shkurtra, pikë së pari do të duhej të merreshin me promovimin e ecjes në këmbë, si një alternativë e shëndetshme dhe më e preferuar kundrejt përdorimit të mjeteve motorike. Normalisht që kjo punë kërkon edukimin shtesë të praktikimit të ecjes dhe përdorimit të biçikletave, në mënyrë që të bëhen ndërhyrje në rrugë të caktuara. Ndërhyrje të tilla janë veçanërisht të nevojshme nëpër kryqëzime, duke i bërë ato më të sigurt për kalimtarët, pastaj përmirësimi dhe nivelimi i trotuareve, ndriçimi i rrugëve dhe si më e rëndësishmja - ndërtimi i shtigjeve të reja për këmbësor dhe çiklistë.

Vështërsitë në lëvizje janë të ndryshme. Për shembull, për këmbësorë është uzurpimi i trotuareve. Këtu hyjnë edhe prindrit me fëmijë në karrocë, të cilët, në mungesë të infrastrukturës të pa standardizuar të trotuareve, janë në rrezik të vazhdueshëm. Çiklistët nuk kanë shtigje të dedikuara për ta. Pastaj, personat me nevoja të veçanta ballafaqohen me mungesë të rampava dhe lehtësive tjera për të lëvizur. Të gjitha këto janë pasojë e mungesës së nivelimit dhe mos lidhshmërisë së trotuareve por edhe qasjes shumë të kufizuar në rrugë, sheshe por edhe institucione. Cenimi i qasjes së barabartë të pjesëmarrësve në trafik dhe vështirësitë e lëvizjes në rrugë të këtyre pjesëmarrësve, padyshim se kanë ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë dhe të drejtat e njeriut.

4. Propozim për masa konkrete për përmirësimin e kushteve për lëvizjen e këmbësorëve

Me qëllim të rritjes së sigurisë në lëvizje si e drejtë e garantuar për të gjithë, një studim serioz për lëvizjen e këmbësorëve mund të ndihmojë edhe më tej në identifikimin e fushave problematike. Ky studim do të mundësonte sigurimin e informacionit të vlefshëm mbi origjinën e

problemeve në trafik dhe po ashtu do të jipte rekomandime se si do të mund të zgjidheshin ato probleme.

Hulumtimi i tillë do të duhej të gjejë përgjigje të bazuara në pyetjet se kah po lëvizin këmbësorët? Cilat janë destinacionet e tyre? Çfarë ankesash dhe vështirësi kanë ata kur dalin në rrugë (në intervalet mujore, javore, kohore, flukset gjatë ditës ose natës)? Cilat janë propozimet dhe rekomandimet e tyre (si përdorues konstant të segmenteve të caktuara të rrugëve), bazuar në praktikat e tyre etj.

Hulumtimi do të duhej të përfshinte të gjitha komunat e vendit, dhe të gjeturat e hulumtimit do ta pasqyroin gjendjen reale në trafik. Po ashtu, këto të gjetura, do të mund të përcilleshin me propozime dhe rekomandime konkrete për krijimin e sigurisë në rrugë, veçanërisht për pjesëmarrësit e përmendur më lartë,

Siguria e lëvizjes në rrugë është shqetësim i vazhdueshëm i të gjithë neve. Që nga viti 2010 e tutje, ky shqetësim është cekur edhe në raportet e progresit të Komisionit Evropian. Në raportin e vitit të kaluar, shprehet brengosja se norma e aksidenteve të trafikut mbetet e lartë, veçanërisht për sa i përket viktimave fëmijë dhe këmbësorë.

Implementimi i masave konkrete intervenuese, do të kishte përmirësuar kushtet e lëvizjes së këmbësorëve dhe çiklistëve. Rrjedhimisht, kjo do të kontribuonte në krijimin e një ambienti më të sigurt gjatë lëvizjes në rrugë dhe do ta radhiste vendin tonë në grupin e vendeve të cilat si fokus të shoqërisë e kanë qytetarët..

Muhamed A. Krasniqi, drejtor
Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike *Tempulli*
meti@tempulli.org